

MIGENA SHYTI KAPLLANI

VALENCAT FOLJORE DHE FJALORËT E VALENCËS

1.1. Folja gjymtyra kryesore

Sipas teorisë së valencës, folja shoqërohet me një numër të caktuar gjymtyrësh. Sipas llojit të foljes strukturohet dhe fjalia. **Folja bëhet e rëndësishme për ndërtimin gramatikor të fjalisë.** Në formimin e fjalive, janë foljet elementet që luajnë një rol determinant. Një nga shumë gjuhëtarët e bindur për rolin qendror të foljes është Herald Weinrich¹, që e quan **foljen qendra programuese e teksteve**. Ajo është elementi përbërës kryesor dhe forca strukturore që krijon dhe organizon fjalinë. Folja ka një aftësi të veçantë që të drejtojë elemente të tjera, të hapë vende bosh, të cilat mbushen.

Dikur gjuhët e huaja dhe njohja e tyre shiheshin si pjesë e bagazhit dhe kulturës së personit, kurse sot ato janë më tepër mjet utilitar ose për përdorim të përditshëm. Ky vizion për gjuhët moderne, u intereson dhe fjalorëve. Madje sot kërkohet një fjalor i valencës; për lehtësimin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, për qëllime korrigjimi, për qëllime dokumentimi të gjuhës, për qëllime të përpunimit teknologjik të gjuhëve natyrore. Një fjalor i tillë mund të japë për çdo zë saktësisht vlerën e fjalëve (llojet dhe numrin e plotësorëve që u duhen) si dhe strukturën e fjalisë në të cilën ajo përdoret. Po kështu të shënohet sasia e plotësorëve të nevojshëm për ndërtimin e fjalive gramatikale. Sot me format e teknologjisë që po përdoren për mësimin e gjuhëve të huaja, do të ishte më tepër i nevojshëm krijimi i një fjalori të tillë, sepse përcakton natyrën e fjalisë sipas nevojës që ka folja për t'u plotësuar, në varësi të valencës së saj.

Ky fjalor është quajtur, *fjalor i ndërtimit*, që i përket grupit të fjalorëve sintagmatikë dhe ofron për përdoruesit në mënyrë sistematike informacione të domosdoshme për përdorimin korrekt të foljeve.

Dihet që përdorimi i rregullt i fjalëve varet nga një njohje shumë e mirë e sintaksës. Për një përdorim adekuat të gjuhës, të njohësh sintaksën sigurisht nuk është e mjaftueshme, por është e rëndësishme. Nën këtë vështrim thuhet që folja është ajo që ndihmon në ndërtimin e fjalive. Po të shohësh nga një numër shembujsh fjalish të përkthyer nga italishtja në gjermanisht, me ndihmën e një fjalori dygjuhësh² të përgjithshëm, tregohet:

¹ *Text grammatik der deutschen Sprache* (1993).

² MARIE A. RIEGER, Università di Bologna "Tra i dizionari bilingui tedesco-italiani di taglia media, il DIT è fra i migliori, nonostante mostri anch'esso delle lacune nel campo

- në ç’ mënyrë foljet programojnë fjalitë;
- cilat informacione që i përkasin përdorimit të foljeve janë dhënë nga fjalori dygjuhësh (tradicional);

- cilat informacione janë të nevojshme për përdorim korrekt të foljeve.

Po ta shohim problemin lidhur me këtë që përmendëm më sipër, një fjalor i zakonshëm dhe i përgjithshëm dygjuhësh, sado i mirë të jetë, nuk ndihmon tërësisht në ndërtimin e saktë gramatikal të fjalisë.

1.2. Gramatikaliteti dhe fjalitë e pranueshme

Në të gjithë si folës të lindur të gjuhës sonë dallojmë menjëherë, përmes bazës empirike të sintaksës saktësinë ose jo të një fjalie të përdorur. Fjalia në lidhje me gramatikalitetin, mund të jetë gramatikore dhe jogramatikore, që jo domosdoshmërisht do të jetë e barasvlefshme me termat i saktë i pasaktë, por “i formuar saktë për folësin e lindur të një gjuhe të caktuar” dhe “jo e formuar mirë, por që kuptohet gjithsesi”. Këtu nuk mbështetet teza e padobisë së një gramatike normative, por kufizimet në gjuhën e përditshme, të përdorimit të fjalive, nuk njihen. Ata nuk njohin një formë të zyrtarizuar, megjithatë fjalitë kuptohen lehtësisht. Rëndësi ka të kuptohet qartë ajo që folësi kërkon të na thotë. Sepse mund të ndodhë që të kemi një fjali të saktë nga ana sintaksore, por që është e pakuptueshme dhe e paqartë për dërguesin³.

1.3. Tri nivelet e përshkrimit foljor

Një folës i një gjuhe të huaj mund të kuptohet nga personi folës i asaj gjuhe, por fjalia është e ndërtuar jo drejt në aspektin sintaksor. Për këtë arsye, duhet që fjalorët të jenë të plotësuar dhe me të dhëna të tjera që lehtësojnë formimin gramatikor të fjalive. Kështu mund të shohim:

Shembulli 1

(1) Getto il salame, è andato male.

Nëse do shohim një fjalor, dygjuhësh, menjëherë folja ‘gettare’, do të përkthehej në gjermanisht ‘werfen, wegwerfen’. Po të ndërtonim fjalinë me të parën, do të kishim në gjermanisht këtë fjali:

(1a) *Ich werfe die salami, sie ist schlecht geworden.

Kjo fjali rezulton jogramatikore⁴ sepse në gjermanisht werfen, kërkon detyrimisht tre “plotësorë”, një subjekt, një kundrinor të drejtë dhe një plotës drejtimi, vendin ku duhet ta hedhë.

della sintassi verbale, come dimostreranno gli esempi. I dizionari della valenza verbale e l’insegnamento del tedesco come lingua straniera”.

³ Giorgio Graffi, *Sintaksa*, Dituria 2003, f. 28.

⁴ Marie A. Rieger, Università di Bologna “Tra i dizionari bilingui tedesco-italiani di taglia media, il DIT è fra i migliori, nonostante mostri anch’esso delle lacune nel campo della sintassi verbale, come dimostreranno gli esempi. I dizionari della valenza verbale e l’insegnamento del tedesco come lingua straniera”.

P.sh.: (1b) Ich werfe die Salami in den Mülleimer. (Getto il salame nel secchio dei rifiuti. Hedh sallamin në koshin e plehrave.)

Vetëm fjala “wegwerfen” jep mundësinë të ndërtohet një fjali e saktë me dy plotësorë si në italisht.

(1c) Ich werfe die Salami weg. (Getto via il salame. Hedh tutje sallamin.)

Në **nivelin e parë**, pra duhet të jetë treguar sasia e plotësorëve të nevojshëm për ndërtimin gramatikal të fjalisë.

Shembulli 2

Mi sono abbonata a una rivista linguistica. (U abonova në një revistë gjuhësore.)

Shprehja ‘abbonarsi a qcs’ (abonohem tek diçka), përkthehet në gjermanisht ‘etwas abonnieren’. Problemi në këtë rast qëndron në faktin që *etwas* ose ‘diçka’, mund të jetë kundrinor në dhanore ose kallëzore. Për ta përkthyer nga italishtja në gjermanisht frazën, do përdornim një kundrinor ekuivalent në dhanore dhe përkthimi më bindës do ishte:

(2a) *Ich hab einer linguistischen Zeitschrift [dhanore] abonniert.

Në fakt, fraza (1) rezulton jogramatikore, sepse folja në gjermanisht abonnieren, kërkon një kundrinor në kallëzore:

(2b) Ich habe eine linguistische Zeitschrift [kallëzore] abonniert.

Duke qenë se gjermanishtja ka ruajtur një pasuri morfologjike, në një **nivel të dytë** është absolutisht e nevojshme të tregohet cilësia ose forma morfologjike e kundrinorëve.

Shembulli 3

Il sole riscalda la veranda. (Dielli ngroh verandën.)

Për të përkthyer *riscaldare*, fjalori vendos foljet ‘heizen’ ose ‘beheisen’:

(3a) Die Sonne heizt/beheizt die Veranda.

Kjo fjali, në një vështrim të ngushtë gramatikor është korrekte. Megjithatë do të gjykohej e gabuar. Informacioni që fjalori nuk siguron është ai që folja ‘heizen’ kërkon një subjekt njerëzor. Për ta përkthyer, *riscaldare* për objekte jonjerëzore, në gjermanisht duhet të përdoret ‘wärmen’:

(3b) Die Sonne wärmt die Veranda.

Pra **niveli i tretë** është ai i (jo)kompatibilitetit semantik.

Duke u nisur nga koncepti se folja është qendra e fjalisë, që dallohet nga valenca si karakteristikë universale e foljeve, dallohen dhe përcaktohen foljet si monovalente, relative (dyvalente) dhe trivalente. Valenca, është një “cilësi sasiore” e foljes, sepse folja jo vetëm përcakton cilësinë, por dhe sasinë e elementeve linearë. Mbi bazën e së famshmes “metafora e dramës” elementet e varura të foljes janë quajtur plotës (aktantë) dhe rrethanorë⁵.

⁵ Nyja foljore [...] shpreh gjithë një dramë të vogël. Si në një dramë në fakt, ajo përmban detyrimisht një proces dhe më shpesh aktorë dhe rrethana. Duke e transportuar nga plani i realitetit dramatik në atë të sintaksës strukturale, procesin, aktorët dhe rrethanat, bëhen

Këta fjalorë, të klasifikuar si sintagmatikë e më saktë “konstruktues”, janë një instrument për të prodhuar. Siç përmend në parathënien e saj një autore e një fjalori të tillë, dygjuhësh italian – gjerman: “një fjalor valencash është mbi të gjitha një fjalor produktiv përderisa përmban tregues sintakso-semantikë e fjalishembuj, të nevojshëm për prodhimin e **fjalive të pranueshme**.”⁶ Dhe kjo është e rëndësishme në këtë kohë kur ne e përjetojmë mësimin e gjuhës jo më si kulturë, por si një nevojë jetike, kur mësimi i tyre duhet të bëhet në një mënyrë të natyrshme e shpejt rezultative.

1.3.1. Elementet përbërës të një fjalori valencash

E kemi fjalën këtu për një fjalor dygjuhësh. Folja jepet së pari në formën përfaqësuese, në shqip: në vetën e parë, numri njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore. Pastaj jepen kohët e tjera themelore, ose format morfologjike plotësuese. Të tilla janë ato forma kohore që shërbejnë si rrënjë ose tema trajtëformuese. Në gjuhën shqipe shërbejnë si të tilla: veta e dytë njëjës, veta e tretë njëjës, veta e dytë shumës, aoristi, pjesorja.

Pastaj jepet kuptimi si përkufizim ose si përshkrim. Në një rubrikë më vete jepet fjalëformimi, fjalët që formohen nga folja e dhënë.

Vijohet me planin e fjalisë ku bën pjesë kjo folje. Në plan jepen plotësat (aktantët) që drejton ajo folje, plotësat e detyrueshëm, plotësat fakultativë. Mund të jepen dhe rrethanorët (zakonisht në kllapa katrore).

Plani i fjalisë detajohet më tej me semantikën e elementeve përbërëse të saj. Gjithçka ilustruhet me shembuj. Në paraqitjen e një foljeje nuk mungon dhe informacioni për formën pësore të saj, për formimin dhe përdorimin e pësorës.

Do të japim disa shpjegime për paraqitjen e semantikës së gjymtyrëve përbërëse të planit ndërtimor të fjalive. Në fjalorë valencash shpjegimet semantike janë shumë të rëndësishme, sepse valenca, aftësia drejtuese e lidhëse e foljeve është jo vetëm gramatikore, por dhe semantike. Kështu, pranohet në zhvillimet e sotme të teorisë së valencave, që plotësat, qofshin gjymtyrë fakultative ose të detyrueshme, lidhen vetëm me folje të caktuara, me folje me kuptim të caktuar dhe jo me çdo folje, siç ndodh me rrethanorët.

Janë bërë shumë studime e kërkime në fushë të semantikës së gjymtyrëve që kushtëzohen semantikisht nga folja. Ne po ndalemi në një prej teorive, që është dhe më e përdorura, në teorinë mbi relatorët semantikë të U. Engel⁷ (Max Niemeyer Verlag, Tübingen, 1996).

respektivisht folja, aktantët dhe rrethanuesit (Tesnier 1959: 102, cituar në Askedal 2003, f. 90).

⁶ Divti, 1996, Maria Teresa Bianco.

⁷ U. Engel. *Max Niemeyer Verlag*, Tübingen, 1996, f. 83.

Valencat foljore dhe fjalorët e valencës

Siç ndodh shpesh në teorinë e valencave, parapëlqehen terma ndërkombëtarë, zakonisht me prejardhje latine. Ne do ta ruajmë emërtimin latin, por, gjithsesi, do të bëhet shpjegimi përkatës.

Sipas Engel-it plotësat, në pikëpamje semantike, mund të grupohen:

1. Lokativë (LOC)

Fjalët e këtij grupi shënojnë vend dhe u përgjigjen pyetjeve: *ku? nga ku? për ku?* etj.

Zakonisht kategoria e lokativëve shprehet me një frazë parafjalore:

Eraldi ndenji në shtëpi.

Dje udhëtova për në Tiranë.

Era është nga Vlora.

Duke hetuar më tej përmbajtjen e njësive të këtij grupi, mund të bëjmë dhe nënndarje të tjera, si:

LOC - vend

LOCabl. (rrjedhor) – vendnisje

LOCall – vend mbërritje

LOCprt – hapësirë e përshkruar

LOCdir - drejtim.

Në gjuhën shqipe kjo gjymtyrë mund të shprehet dhe me një emër në rasën rrjedhore me parafjalë ose pa parafjalë. Lokativët përdoren pas foljesh, si: *vij, çoj, dërgoj, shkoj, udhëtoj* etj.

2. Klasifikativët (KLS)

Emërtohen kështu, sepse këto fjalë shënojnë klasën ku përfshihet një objekt a një person. U përgjigjen pyetjeve *kush, çfarë*:

Agimin e emëruan drejtor shkolle.

Nga Saulus u bë Paulus.

Edhe klasifikativët mund të analizohen e të ndahen më tej.

KLSabl – gjendja fillestare

KLSall – rezultati i zhvillimit

3. Agjentivë (AGT)

Të gjitha foljet që kanë një formë të plotë pasive (zakonisht folje transitive që shprehin veprim) kërkojnë një subjekt agjentiv:

Agimi po shkruan një letër. (Letra po shkruhet nga Agimi.)

Karakter i agjentiv i subjektit mund të jetë i shkallëve të ndryshme, i fortë, më pak i fortë, i dobët: AGT'(i fortë), AGT'' (më pak i fortë) është i mundshëm vetëm pasivi i përgjithshëm si; punohet, flihet etj., AGT''' (i dobët), folje që kanë formë pasive.⁸

1. Afektivë (AFF)

⁸ Ulrich Engel, *Semantischen Relatoren*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1996, f. 85.

Në këtë rast plotësi shënon një madhësi jovepruese, pasive, që mund të jetë thjesht e pranishme në ngjarjen (e shprehur nga folja).

Agentivët dhe afektivët mund të precizohen më tej:

a) Effektiv (eff) – (AGTeff, AFFeff)

Është fjala për objekte/persona që nën veprimin e foljes krijohen ose zhbëhen:

Shuaj dritën, shuaj zjarrin, djeg letrën, botoj librin

b) Mutativ (mut) – (AGT mut, AFF mut)

Në këtë rast objekti/personi i shënuar nga plotësi pëson ndryshim cilësor ose hapësinor:

Vajza skuqet, pema lulëzon, hekuri bymehet/tkurret/

c) Ferens (fer) – (AGTfer, AFFfer)

Madhësia e shënuar nga plotësi nuk ndryshon gjatë procesit të shënuar nga folja. Ajo shërben si bartëse e këtij veprimi:

A e sheh atë pikën e zezë?

Kjo veçori semantike vihet re në subjektet e foljeve si: *mendoj, fle*, në plotësat (dhanore, kallëzore) e foljeve: *sjell, shikoj* etj.

Kështu, inventari i përgjithshëm përmban vetëm katër relatorë (pa përfshirë nënkategoritë):

Agentiv	AGT	(AGTeff, AGTmut, AGTfer) ⁹
Affektiv	AFF	(AFFeff, AFFmut, AFFfer)
Lokativ	LOC	(LOCall, LOCabl, LOCdir)
Klasifikativ	KLS	(KLSall, KLSabl.)

Me një inventar të tillë të kufizuar mund të përshkruhen fjali nga më të ndryshmet.

Sigurisht, fjalët – plotësa përmbajnë dhe veçori ose përbërës të tjerë kuptimorë. Këta janë pjesë përbërëse e kuptimit, por nuk luajnë rol në aftësinë kuptimore- kombinatorë të foljes.

Krahas relatorëve semantikë të mësipërm, në fjalorët e valencave jepet dhe një informacion shtesë po i llojit semantik që ka të bëjë me veçori të tjera kuptimore të fjalëve që lidhen në fjali. Edhe këto veçori luajnë rol në kombinimet folje + plotës.

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur emërtimet e plota dhe simbolet e të dhënave shtesë, të cilat jepen për çdo plotës, në mënyrë që përshkrimi kuptimor-gramatikor të ketë vlerë përdorimore-pragmatike:

⁹ Ulrich Engel, *Semantischen Relatoren*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1996, f. 85.

Valencat foljore dhe fjalorët e valencës

mat	diçka materiale
anim	frymor
hum	qenie njerëzore
inst	institucion
zool	kafshë
plant	bimë
inanim	jofrymor
obj	sende të numërueshme
mas	sende të panumërueshme
immat	dukuri jomateriale
sachv	përmbajtje
akt	aktivitet, veprim, proces
stat	gjendje, veçori
intell	të ndryshme

Sot, me zhvillimet që ka marrë shoqëria, me hapjen e saj si dhe lidhjet midis popujve, kanë ndikuar edhe në përvetësimin dhe kërkesën për të mësuar gjuhët e huaja, të cilat nuk është koha të mësohen me pedagogjinë dhe metodat e vjetra. Nëse dikur shiheshin si pjesë e kulturës së një personi, sot janë një nevojë e domosdoshme për të jetuar lëvizjen. Pikërisht kjo ndihmohet përmes fjalorëve të valencës të cilët japin për çdo zë saktësisht vlerën e fjalëve (llojet dhe numrin e plotësorëve që u duhen) si dhe strukturën e fjalisë në të cilën ajo përdoret. Në këto fjalorë, folja bëhet e rëndësishme për ndërtimin gramatikor të fjalisë.

BIBLIOGRAFIA

Divti, 1996, Maria Teresa Bianco.

Giorgio Graffi, *Sintaksa*, Dituria 2003.

Herald Weinrich, *Textgrammatik der deutschen Sprache* (1993).

Marie A. Rieger, Università di Bologna “*Tra i dizionari bilingui tedesco-italiani di taglia media, il DIT è fra i migliori, nonostante mostri anch'esso delle lacune nel campo della sintassi verbale, come dimostreranno gli esempi.*” “I dizionari della valenza verbale e l’insegnamento del tedesco come lingua straniera”.

Tesnier Lucien, *Éléments de syntaxe structurale* 1959.

U. Engel, *Max Niemeyer Verlag*, Tübingen, 1996.

Ulrich Engel, Emine Sadiku, *Valenzlexikon Deutsch –Albanisch* (në proces).

Ulrich Engel, *Semantischen Relatoren*, Max Niemeyer Verlag, Tübingen 1996.